

# Kërkesë e përbashkët për përfshirjen e komenteve në Koncept Dokumentin për Shëndet Mendor

Data: 08.11.2022

Drejtuar: Zj. Laura Shehu, Udhëheqëse e Divizionit për Shëndet Mendor

Ne, të poshtëshënuarit e kësaj kërkesë publike, kërkojmë përfshirjen e komenteve të poshtëshënuara në Koncept Dokumentin për shëndet mendor, duke përfshirë një Linjë të financuar nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës për parandalimin e vetëvrasjes në ligjin e ri për shëndet mendor.

Me datën 19 Tetor është publikuar koncept dokumenti për shëndet mendor, i cili shpalosë analizën mbi gjendjen e shëndetit mendor në Kosovë dhe problemet kyçe rreth trajtimit të shëndetit mendor të qytetarëve. Ndër problemet kryesore identifikohet ligji aktual i shëndetit mendor, në mënyrën se si është hartuar por edhe në zbatueshmërinë e tij.

Konkluzioni kryesor i koncept dokumentit për shëndet mendor është hartimi i një ligji të ri për shëndet mendor, i cili do të adresojë problemet e identifikuar me ligjin aktual dhe zbatueshmërinë e tij.

Sidoqoftë, ndonëse koncept dokumenti identifikon mungesa të ndryshme në ligjin dhe politikat aktuale (siç është mungesa e një strategjie kombëtare për parandalimin e vetëvrasjes), shohim se ka ende mundësi për përmirësim dhe përfshirje të komponentëve të cilët sigurojnë funksionalizimin e shërbimeve emergjente, proaktive dhe gjithëpërfshirëse.

Në vijim janë propozimet, të shoqëruara me shpjegimin e propozimit:

1. Vetëvrasja dhe tentim-vetëvrasjet vazhdojnë të jenë brengë për popullatën Kosovare. Deri më tani në Kosovë janë raportuar mbi 1,000 vetëvrasje dhe mbi 4,000 tentime në vetëvrasje, ndërsa vetëm në vitin 2021 janë raportuar 41 vetëvrasje dhe 130 tentime.

Meqenëse Republika e Kosovës ende nuk ka strategji për parandalimin e vetëvrasjes apo shërbime funksionale që i dedikohen parandalimit të vetëvrasjes, një pjesë domethënëse e barrës është menaxhuar nga shoqëria civile, duke përfshirë mirëmbajtjen e linjës së vetme për parandalimin e vetëvrasjes, Linja e Jetës. Ne, organizatat e shoqërisë civile, nuk po e shohim këtë realitet si diçka që mund të ketë qëndrueshmëri afatgjatë dhe rrjedhimisht kërkojmë përfshirjen e institucioneve përkatëse në ndërmarrjen e hapave konkretë mbi parandalimin e vetëvrasjes, duke filluar me funksionalizimin e Linjës Kombëtare për parandalimin e vetëvrasjes.

Respektivisht, kërkojmë që në kapitullin 3.3: “Opsioni i tretë - Ndryshimi i politikës ekzistuese” të parashihet gjithashtu funksionalizimi i Linjës Kombëtare për parandalimin e vetëvrasjes. Kjo do të përfshinte:

- Funksionalizimin e numrit 116 123, për ndihma psikologjike për persona me mendime për vetëvrasje ose në gjendje të rëndë psikologjike, ashtu siç parashihet në Rregulloren për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës.
- Për këtë shërbim të mundësohet kontraktimi i personelit përgjegjës për realizimin e shërbimit.

- Të funksionojë kjo linjë 24 orë brenda ditës, 7 ditë në javë.
  - Të mbikëqyret prej dikastereve përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.
  - Fondet për financimin e kësaj linje të sigurohen nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës.
  - Profesionistët shëndetësor, veçanërisht shërbimet emergjente duhet të trajnohen të identifikojnë rrezikun nga vetëvraska dhe tentim vetëvraska dhe në mënyrë aktive të bashkëpunojnë me shërbimet e shëndetit mendor.
2. Ndër grupet më të cenuar të shoqërisë dhe më të ndikuar nga çrregullime të shëndetit mendor janë grupet minoritare, qoftë kjo nga diskriminimi me të cilën ballafaqohen, mospranimi në familje apo niveli i ulët i mundësive për të marrë shërbime. Mungesa e një analize mbi këtë çështje rrezikon që koncepti dokumenti të paraqes realitetin vetëm për burra shqiptar heteroseksual. Rrjedhimisht kërkojmë që:
- Të analizohet literatura aktuale mbi gjendjen e shëndetit mendor të komuniteteve pakicë (LGBTI+, komuniteteve etnike, komuniteteve fetare, etj.)
  - Të merren parasysh sfidat dhe barrierat e këtyre komuniteteve për qasje në shërbime.
  - Të përfshihen këto pika në analizimin e problemit
  - Në opsionin 3 të parashihet aftësimi i personelit të shëndetit mendor në trajtimin e këtyre grupeve, duke ofruar trajnime për rritje të ndjeshmërisë, terminologjisë së saktë, etj. Gjithashtu të parashihet aftësimi i personelit të shëndetit mendor, mjekëve të përgjithshëm dhe psikologëve klinik dhe shkollor në trajtimin e mendimeve dhe sjelljeve vetëvrasëse, përfshirë dhe sjelljet vetë-lënduese.
3. Punimet e cituara në “Kapitulli 1. Përkufizimi i problemit”, ndonëse janë relevante për historinë e Kosovës, janë të vjetëra dhe jo-domosdoshmërisht reflektuese në gjendjen e tanishme (hulumtimi më i ri i cituar është 12 vjet i vjetër). Kjo nuk e vë në dyshim urgjencën me të cilën kemi nevojë për të intervenuar në fushën e shëndetit mendor, mirëpo e penalizon kuptimin tonë të problemit në qoftë se të dhënat të cilat i shfrytëzojmë janë të vjetra. Atëherë, kërkojmë që
- Të shqyrtohet literatura për hulumtime më moderne dhe të përfshihen këto në përkufizimin e problemit.
  - Të plotësohet literatura ekszituese edhe me studime më të reja të realizuar nga departamenti i psikologjisë. Disa prej këtyre studimeve mund mos të jenë reprezentative për popullatën, por prapë evidentojnë gjendjen aktuale për grupe/ popullata specifike.
  - Deri në nisjen e procesit për hartim të Ligjit, Ministria të ndërmarrë/kontraktojë një hulumtim të popullsisë përmes të cilit identifikohet gjendja dhe nevojat kryesore për shëndet mendor për të gjithë qytetarët dhe qytetaret e Kosovës.

- Koncepti dokumenti aktual të informohet nga qasje specifike teorike të cilat do të mund të udhëzonin hapat drejt parandalimit dhe intervenimit në lidhje me shëndetin mendor
4. Raportimet mediatike të vetëvrasjeve në Kosovë nuk janë të rregulluara me ligj apo me ndonjë udhëzim, gjë që rezultoi në raportime të cilat vazhdimisht evokojnë efektin Werther në popullatën Kosovare. Këtu nuk i referohemi identitetit apo gjendjes mjekësore të individëve (të dhëna të cilat mbrohen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale), por raportimeve të cilat shkaktojnë panik në popullatë, glorifikojnë vetëvrasjen, apo ndonjë formë tjetër e raportimit e cila në bazë të hulumtimeve ndikon në rritjen e numrit të vetëvrasjeve.

Opsioni i tretë në Koncept Dokumentin për Shëndet Mendor kërkon ndryshimin e politikës ekzistuese. Ne kërkojmë që në kuadër të ligjit të përfshihet gjithashtu mundësia për të plotësuar politikën mbi raportimin e këtyre rasteve. Kjo nënkupton:

- Hartimin e një udhëzuesi mbi raportimin e vetëvrasjeve për media (portale, gazeta, televizione, radio, etj.) në bazë të praktikave ndërkombëtare të cilat sigurojnë mirëqenien e lexuesve.
  - Formimi i grupit punues për hartimin e këtij dokumenti.
  - Obligimi i mediave (portaleve, gazetave, televizioneve, radiove, etj.) në aplikimin e këtij udhëzuesi.
5. Një shqetësim i paraqitur në veçanti nga komuniteti LGBTI+ është trajtimi i tyre nga disa profesionist të shëndetit mendor me teknika të cilat nuk janë të bazuar në shkencë për “kurim nga homoseksualiteti”. I rikujtojmë të gjithë se këto praktika janë duke u ndaluar vazhdimisht në shtete moderne për shkak të dëmit të cilën e shkaktojnë në anëtarë të komunitetit LGBTI+ dhe faktit se nuk janë të bazuara në shkencë. Andaj, karshi opsionit 3 për ndryshimin e politikave ekzistuese kërkojmë që:
- Të shqyrtohet mundësia e ndalimit me ligj të praktikave të cilat nuk kanë bazë shkencore apo që janë të evidentuar se kanë kundër efekt në pacientë/e.
  - Formimi i grupeve monitoruese të cilët vëzhgojnë dhe penalizojnë individët të cilët dëmtojnë pacientët/klientët nëpërmjet praktikave të lartcekura.
6. Meqenëse Koncepti Dokumenti për Shëndet Mendor synon që të jetë dokument gjithëpërfshirës i situatës së shëndetit mendor në Kosovë, brengë e paraqitur vazhdimisht është mungesa e profesionistëve të fushave tjera apo të ministrive relevante në punimin e saj. Psikologët, punëtorët social, aktivistët e të drejtave të njeriut, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të gjithë janë pjesë e zinxhirit të shërbimeve të shëndetit mendor. Andaj, rekomandojmë që:
- Në hapat vazhduese të krijimit të ligjit, të sigurohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të grupeve të lartcekura.
  - Mbi konceptin dokumentin aktual, të merren mendimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për plotësim të analizës së problemit.

Konsiderojmë se përfshirja e këtyre pikave do t'i shërbejnë të mirës publike dhe do të sigurojë jetëgjatësi për një shërbim shëndetësor esencial për qytetarët e Kosovës.

Emri i Organizatës	Fushat kryesore të veprimit të organizatës	Informatat e kontaktit (adresa, e-mail, telefoni)
OJQ "Qendra për Informim dhe Përmirësim Social"	Ndihmë sociale dhe psikologjike	Adresa: Rr. Muharrem Fejza, kompleksi "ROYAL", Hyrja C15/13, kati 2 nr. 9 E-mail: contactqips@gmail.com Tel.: +383 49 447 234
Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA	Barazi gjinore	Adresa: Rr. Hajdar Dushi C2, Nr 6 E-mail: office@qika.org Tel: +38345230205
OJQ THY	Fuqizimi i rinisë	Adress: Rr. Ismet Jashari Kumanova, nr.106, Prizren, Kosovë E-mail: ngothy2021@gmail.com Tel: +383 38 210044
Dylberizm	Edukim dhe informim mbi çështjet LGBTQ+	dylberizm@gmail.com www.dylberizm.com
OJQ Fearless Minds Kosovo (FLMK)	Ndihmë sociale dhe psikologjike	Adresa: Qamil Bala 35, Bregu I Diellit, Prishtinë. Email: info@flmkosovo.org Tel: +38344430348
OJQ RRITU (Komuniteti Termokiss)	Termokiss është qendër e drejtuar nga komuniteti në Prishtinë me mision këmbimin urban dhe civil, reflektimin dhe ndryshimin.	Adresa: Rruga Ilaz Kodra, p.n, Prishtinë Email: termokiss@gmail.com Tel: +38344354242
OJQ truAktiv	TruAktiv është program alternativ i edukimit që synon avansimin e mendimit kritik dhe qasjeve kritike në të kuptuarit e shoqërisë, politikës dhe kulturës.	Adresa: Xhorxh Bush, ProCredit Bank, Hyrja 32/7 Email: truaktiv@gmail.com Tel: + 383 49 166 968
OJQ SpaceSyntaKs	SpaceSyntaKs është një institut hulumtues, puna kryesore e të cilit	Adresa: Rexhep Luci, 19/13, Prishtinë Email: spacesyntaks@gmail.com Tel: +383 49 558190

	<p>konsiston në kryerjen e hulumtimeve me në qendër njeriun për të thelluar të kuptuarit e raportit të fenomeneve urbane me kushtet e tyre socio-ekonomike.</p>	
ACTIVISM ROOTS	<p>Activism Roots është organizatë që punon në ngritje e aktivizmit qytetar dhe ngritjen e kapaciteteve të të rinjëve.</p>	<p>Adresa: Ismail Qemajli, n.n, Gjakovë  Email: info@activismroots.org ose activismroots@gmail.com  Tel: +38348124200</p>
CEL Kosova	<p>CEL Kosova është organizatë që mbron dhe promovon të drejtat e personave LGBTI ne Kosove.</p>	<p>Adresa: Tring Smjali, Prishtine  Email: info@cel-ks.org  Tel: +38349509649</p>
Youth Initiative for Human Rights – Kosovo	<p>Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (Youth Initiative for Human Rights – Kosovo (YIHR KS)) është themeluar në vitin 2004. YIHR KS është e fokusuar në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, si dhe fuqizimin e rinisë në nivel lokal dhe rajonal.</p>	<p>Adresa: rr.Adrian Krasniqi, nr. 5, Prishtinë  Email: ks_office@yih.org  tel: +383 38 748 018</p>
Fondacioni BONEVET Prishtina	<p>BONEVET është institucion jo-formal i edukimit që inkurajon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të identifikojnë dhe zhvillojnë talentet dhe aftësitë e tyre përmes edukimit STEAM.</p>	<p>Adresa: Rr.Hilë Mosi, nr.11, Prishtinë  Email: prishtina@bonevet.org  rinafetahu@bonevet.org  tel: +38344140443</p>
Fondacioni BONEVET Kamenicë	<p>BONEVET është institucion jo-formal i edukimit që inkurajon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të identifikojnë dhe zhvillojnë talentet dhe aftësitë e tyre përmes edukimit STEAM.</p>	<p>Adresa: Rr. Skenderbeu, Kamenicë  Email: kamenica@bonevet.org  arbitethaci@bonevet.org  Tel: +383 49 187 100</p>
Fondacioni BONEVET Mitrovicë	<p>BONEVET është institucion jo-formal i edukimit që inkurajon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të identifikojnë dhe zhvillojnë talentet dhe aftësitë e tyre përmes edukimit STEAM.</p>	<p>Adresa: Rr."Muhamet Gashi", Mitrovicë  Email: mitrovica@bonevet.org  eglantinaavdiu@bonevet.org  Tel: +383 49 187 033</p>

<p>Grupi për Studime Juridike dhe Politike / Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike</p>	<p>Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike është një platformë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike që synon të forcojë sundimin e ligjit në Kosovë përmes procesit gjyqësor strategjik.</p>	<p>Adresa: Rr. Rexhep Luci, nr. 16/1, Prishtinë  Email:office@cskosovo.org  Tel: +383 38 234 456</p>
<p>Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime- SIT</p>	<p>SIT - është organizatë joqeveritare misioni i të cilës është të promovojë dhe të krijojë një shoqëri të barabartë për të gjithë. Kështu që, ne trajtojmë disa nga problemet më sfiduese të të drejtave të njeriut në shoqërinë tonë që na pengojnë për të arritur barazi, paqe, dhe zhvillim, përfshirë këtu dhunën në familje dhe dhunën me Bazë gjinore. Ne synojmë të arrijmë këtë duke përfshirë njerëz të të gjitha prapavijave, pa marrë parasyh gjininë, orientimin seksual apo ndonjë kategori tjetër të identitetit.</p>	<p>Adresa: Rr. Bedri Pejani, Nr.33, Prishtinë,  Email: info@sit-ks.org  Tel: +383 38 223 457</p>
<p>Departamenti i Psikologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”</p>	<p>Misioni i programit baçelor dhe master në psikologji është avancimi i psikologjisë si shkencë dhe profesion përmes arsimit cilësor të të pranuarve, rritjes së kërkimeve shkencore në fushën e psikologjisë, formimit të vlerave më të mira qytetare te studentët, si dhe zbatimit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtarizimit.</p>	<p>Adresa: Rr. Nena Tereze, nn. 10000 Prishtine  departamenti.psikologjise@uni-pr.edu  Tel: +383 38 224 783</p>
<p>ORCA Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim</p>	<p>Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), e themeluar në vitin 2016 në Prishtinë, ka si mision kontributin për rritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë, me fokus kryesor arsimin universitar.</p>	<p>Rr. Henrik Bariç, Prishtinë, Kosovë, 10000  orca.comms@gmail.com  +383 (45) 234 994</p>

<p>OJQ "VISION 02" Komuna Istog e menagjon Qendrën Mësimore me Bazë në Komunitet në fshatin Gjurakoc, tashmë e licencuar nga MASHT.</p>	<p>Rritjen e cilësisë në arsim fillor e parafillorë, si dhe mos braktisje të shkollimit të komuniteteve rom, ashkali, egjptas. Po ashtu punon në programin për Barazi Gjinore, si dhe në edukimin shëndetësor social dhe programe në rini, kulturë dhe sport.</p>	<p>Rruga "7 Marsi", fshati Gjurakoc, Komuna Istog, Qendra Mësimore nr.16</p> <p>Tel: 044 522793 Email: vision02ojq@yahoo.com</p>
<p>Integra</p>	<p>Integra është një organizatë e formuar në vitin 2003 nga një grup njerëzish të angazhuar për të kontribuar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës. Çështjet kryesore që mbulon Integra janë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të pakicave, ballafaqimi me të kaluarën dhe drejtësia tranzicionale, edukimi dhe ndërgjegjësimi, shëndeti riprodhues, transparenca dhe llogaridhënia, mendimi dhe shkrimi kritik, hulumtimi dhe media sociale, bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi, demokracia dhe integrimi evropian.</p>	<p>Adresa: Rr. Rrustem Statovci p.n. Objekti 2, Kati 3, Nr. 3, Prishtinë Email: info@ngo-integra.org Tel: +383 38 246 717</p>
<p>CSGD - Qendra per Zhilliin e Grupeve Shoqerore</p>	<p>CSGD është organizatë që merret me mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave LGBTIQ+ në Kosovë</p>	<p>Adresa: Rr. Imzot Nik Prela 14, 10000 Prishtinë Tel: 038 728 417 Email: info@csgd-ks.org</p>
<p>Qendra Kosovare për Studime Gjinore</p>	<p>Qendra Kosovare për Studime Gjinore është themeluar në vitin 2003. Misioni i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) është integrimi i perspektives gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjitha sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes për çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore, krijimit të politikave të ndjeshme nga aspekti gjinore; përmes hulumtimeve; avokimit dhe lobimit.</p>	<p>Adresa: Nëna Terezë 1/18, 10 0000 Prishtinë Kosovë</p>

Unioni i Punëtorëve Social-UPSK	UPSK është themeluar me qëllim që të promovojë të drejtat e punëtorëve social në Kosovë duke u angazhuar në promovimin e punës dhe vlerave të punëtorëve social në shoqëri për të forcuar rolin dhe pozicionin e tyre	Mitrovicë Veriore, 40550. Kosovë
ETEA	ETEA është themeluar në vitin 2014 me qëllim të edukimit publik përmes zhvillimit të kulturës dhe shkathtësive të leximit tek grupmoshat e reja dhe përmirësimit të gjendjes së arsimit parauniversitar në Kosovë.	Rr. Sadik Bekteshi, nr. 16, 10000 Prishtinë, Kosovë. info@etea-ks.org 044 770 767
Instituti per Politika Sociale “Musine Kokalari”	Instituti “Musine Kokalari” është institut i pavarur që promovon vlerat sociale dhe demokratike, duke u angazhuar për politika progresive në Republikën e Kosovës.	Rruga B, Residio 5, Hyrja B, Nr. 15-1, Ndërtuesi Dervisholli – 10 000, Prishtinë – Republika e Kosovës E-mail: info@musineinstitute.org
Grazeta Media	Grazeta është platformë femineiste në gjuhën shqipe e themeluar në vitin 2020 me qëllimin e promovimit dhe inkurajimit të mendimit kritik dhe si përgjigje femineiste ndaj temave kryesore politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të grave, për të shërbyer si hapësirë e sigurt digjitale.	Prishtinë, 10000 info@grazeta.com +38349869677
Kosovar Youth Council – KYC	Fuqizimi i rinisë përmes edukimit, aktivizimit dhe inovacionit. Përfaqësimi i zërit rinor të Kosovës në botë	Kroi i Bardhe 81, 10000, Prishtinë kyckosova@gmail.com +383 44 964 575
Organizata Kosovare per Talent dhe Arsim - TOKA	Edukimi dhe aktivizimi i te rinjveve te marginalizuar, permes edukimit joformal dhe vullnetarizmit edukativ.	Rruga Meto Bajraktari 4-1 10000, Prishtine <a href="mailto:info@toka-ks.org">info@toka-ks.org</a> +38338704 560
Community Development Fund CDF	Zhvillimi i komunitetit dhe krijimi i kushteve për integrim, akses dhe	Rruga Sejdi Kryeziu nr.32 10000, Prishtine



	<p>përfshirje të barabartë përmes ekspertizës dhe zgjidhjeve inovative, përmes mbështetjes së iniciativave lokale, si dhe ngritjes së kapaciteteve në komunitete.</p>	<p><a href="mailto:nermin@kcdf.org">nermin@kcdf.org</a> +38344113751</p>
--	---	--